



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA JUNIK  
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-06/22
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	31.05.2022
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

**PROCESVERBAL:**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së gjashtë (6) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 31.05.2022, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. **Shpejtim Gacaferi**: i cili në fillim përshëndeti nënkyryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, Drejtori të Drejtorisë komunale, Komandantin e stacionit Policor në Junik z. Rasim Syla, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal, dhe gjithë të pranishmit.

Anëtarët prezent

- |                                      |                                      |
|--------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK      | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK     |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK     | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK    |
| 4. Albertina Gacaferi - Anëtare, LDK | 13. Eliza Pepshi- Anëtare, LVV       |
| 5. Ermelinda Llolluni - Anëtare, LDK | 14. Xhemë Tofaj-Anëtar,LVV           |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK      | Mungon: Lulzim Gacaferi-Anëtar,LVV   |
| 7. Leonard Llolluni - Anëtar, AAK    |                                      |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK        |                                      |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK  |                                      |

### Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë për Zhvillimin e Sektorit te Turizmit në Komunën e Junikut,
3. Informatë rrith qarkores buxhetore 2023/1 qarkorja parë,
  
4. Të ndryshme;

#### **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Sa i përket pikës së parë të rendit të ditës, procesverbal i nuk është pergaditë por kerkojë mirëkuptim e juaj qe ne mbledhjen e radhës do ti keni gati për të dy mbledhjet.

#### **Pika e parë e rendit të ditës**

#### **Informatë për Zhvillimin Sektorit te Turizmit në Komunën e Junikut**

**z. Shpejtim Gacaferi:** Sa i përket kësaj pike informatën e keni pas me kohë Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik në mbledhjen e KPF-së është prezent dhe përgjigjur rrith pyetjeve për të cilat ju kemi drejtuar, Drejtoresha sot mungon sepse e ka një trajnim, por e kemi këtu nënkyetar, besoj qe mundet t'iua përgjigjet pyetjeve të juaja nëse keni.

**z. Leonard Llolluni:** Falemderit Kryesues përvendetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket informatës për Zhvillimin e Sektorit te Turizmit në Komunën e Junikut, unë nuk e vlerësoj si serioze mungesën e Drejtoreshës me raportuar në kete mbledhje sespe është sektori kryesor qe e ka komuna e Junikut si prioritet me planin zhvillimor, zhvillimin e turizmit.

**z. Sadri Krasniqi:** Kam një pyetje lidhur me procedurën e ndërtimit të rrugës se bjeshkës deri ku kan shkuar procedurat, por meqenëse drejtoresha mungon, raportin të cilin e ka dërguar e shoh si rapport shumë të çartë por kisha kerkuar prej Kryetarit dhe të gjithë Drejtoreve qe këto kërkesa mos te mbisin në letër, por të janë të zbatueshme.

**z. Zenel Maloku:** Përvendetje për të gjithë deshta të lidhem me rrugën e bjeshkës shko nje hap shko dy hapa, asfalti ka pas mu kry prej Rampës vjetër deri në Gjocaj atëherë me vazhdu rruga e bjeshkës paret jon mar asfalti sosht shtru tash prej kahit me fillu rruga e bjeshkës? E dyta osht mbledhja e gjashtë në Kuvend mos ta bojmë ketë punë fol sot e përgjigjen ta marim mas 30 dite, mos ta praktikojmë ketë punë kshtu se nëse vazhdojmë kështu po e mshelim kuvendin krejt por të

vinë drejtorët ti marim pergjigjet prej tyne, edhe per pocesverbal po ta lidhi mos e boni shprehi skemi mujt mi kry, por te kryhet dhe te vjen me kohë në kuvend.

### Pika e dytë e rendit të ditës

2. Informatë rreth qarkores buxhetore 2023/1 qarkorja parë,
  - z. **Shpejtum Gacaferi:** Sa i përket kësaj pike prezent e kemi Nënkyetarin e Komunës dhe zyrtarët Kryesor finansiar, nëse dikush dëshiron ta merr fjalën paraprakisht.
  - z. **Zenel Maloku:** Unë kisha pas deshirë qe per ketë pikë ta ndegojmë nënkyetarin vullneti jam osht ky.
  - z. **Besart Tofaj:** Nënkyetari fillimisht përshëndeti anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit, sa i përket kësaj pike unë fjalën e kaloj te zyrtari kryesor finansiar z. Arten Hamza.
  - z. **Arten Hamza:** E informoj Kuvendin lidhur me Informaten rreth qarkores buxhetore 2023/1 qarkorja parë për Komunën e Junikut.
- z. **Shpejtum Gacaferi:** Fjalën e kaloj të Leonard Llolluni .
- z. **Leonard Llolluni :** Falemderit kryesues, sa i përket qarkores parë buxhetore na e dim që kjo shkon në bazë të formulës qe shkon bazuar nga numri i popullsisë, numri i popullsisë që është berë vitin e fundit 6.084.00, nëse behet një regjistrim tjetër ne do të dalim shumë keq me numër të popullsisë sespe ka rënje gjithashtu ka renje edhe të numri i nxënësve në shkolla, por shpresojmë ne te ardhmen të bëhët ndërrimi i formulës, prandaj duhet te merreni seriozisht me ketë qështje në të ardhmen.
- z. **Zenel Maloku:** U ndërlidh me diskutimin e Leonardit, ishalla nuk na numërojnë edhe njehet për regjistrim edhe nga 10 vjetë, spse nëse na numërojnë ne dalim shumë keq, me 600 nxënës në shkolla dhe me 400 shtepi të mshelne në Komunën e Junikut.
- z. **Shpejtum Gacaferi:** Falënderoj anëtaret e kuvendit për kontributin rreth kësaj pike, e beri një informatë lidhur me dy kërkesa për pjesëmarrje në trajnime për anetarët e Kuvendit njëra nga Misioni i OSCE në Kosovë për anetaret e Kuvendit 5 anëtarë nen moshën 35 vjeçare, trajnimi mbahet me datën 3 dhe 4 qershor, trajnimi mbahet ne Hotel Dukagjini në Pejë, ftesa tjetër vjen nga Demos qe i fton Kryesuesin e Kuvendit Anëtaret Kuvendit, përfaqësuesit finansiar përfaqësuesit e komuniteteve qe mbahet në Qarshinë e Jupajve” në Gjakovë në ora 10:00 me datën 02.06.2022.

## Pika e tretë e rendit të ditës

### 3. Të ndryshme

**z. Shpejtim Gacaferi:** Sa i përket kësaj pike nëse dikush nga të pranishmit dëshiron ta merr fjalën?

**Zenel Maloku:** Unë e kam një pyetje sa i përket Komitetit për Komunitete, nëse keni mundësi te na sqaroni përsë ketë muaj nuk është majt takimi.

**z. Shpejtim Gacaferi:** Dëshira jonë është qe Komitetet funksionale të mbajnë takime të rregullta sepse jepin kontributet dhe e ndihmojnë shumë dhe lehtësojnë punën e Kuvendit, nuk e kam informatën se perse nuk është mabjtur takimi këtë muaj per sqarimet mund ti merrni nga Kryesuesja e këtij komiteti.

**z. Dervish Bajraktari:** Falemderoj kryesuesin, e kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Inspeksion, kur do të fillon emërimi i rrugëve lokale në Komunën e Junikut .

**z. Zenun Shala :** U përgjigj për ketë pyetje, emërimi i rrugëve për rrugët e Komunës së Junikut vendimi është marr me 06.03.2019 qe tri vite ne i kemi emrat kerkesa është ka vazhdon por shumë kadale, por deri në fund të vitit do të përfundohen të gjitha.

**z. Dervish Bajraktari:** E kam edhe një pyetje, emrat e rrugëve qe janë a vine ne konsultime me banorët e lagjes apo do te vazhdohet me ata emra, per shembull në lagjen time ka kundërshtime dhe nuk do te lejojmë qe te vendosen ata emra, banorët e lagjes Bajraktar pasi qe ka kundërshtime nëse nuk gaboj edhe ju jeni të informuar qe do ta bëjnë edhe peticion është si kërkesë e banoreve të lagjes.

**z. Zenun Shala:** Unë jam i informuar për kundërshtimet lidhur me emrat qe janë aprovuar, por vendimi është marrë ne Kuvendin Komunal por ne duhet të veprojmë sipas vendimit dhe nuk mundemi ti ndryshojmë sipas rregullores deri në dhjetë vite.

**z. Zenel Maloku:** Unë e kam një peytje për Drejtorin e Sherbimeve Publike, disa herë jam duke ja berë ketë pyetje a nuk po don apo nuk po mundet, kur do ti vendos shenjat e komunikacionit në qendër të Junikut? Edhe ato sheja të cilat i ki qitë i ki qitë keq, jeni duke e qitë edhe policinë ne situat te pa lakkeshme po parkohen kerret ne trotuare, janë duke u rrezikuar nxënësit tuj shku ne shkoll, une e pranoj punën e policisë qe shkojn te shkolla por me mirë te rinë njoni te shkolla dhe tjetri ne qendër mos ti lejojnë kerret te parkohen ne trotuare e qe nxënësit të rrezikohen mos te bohen punët e qorodita jom tuje përsërit disa her ketë punë kerri sigurohet nxënësi rrezikohet, tjetra deshta te di te rruga e Jasqit sa ka dal përqindja e pertjetzes ne rruga qe e pava 17 per % nuk edi ae keni mat a se keni mat ma mire mi lon edhe 3 vjet pa shtru por kur tja qitni rrugs asfaltin mos te metët me vaj mo jom tuj i vet sa ju ka dal përqindja?


- z. Shpejtim Gacaferi:** Ju drejtua Zenelit, vazhdimisht je duke i akuzuar policinë lidhur me parkingun, policia nuk është fajtore për parkingun sespe është vendim i më hershëm për shfrytëzimin e parkingut, deri të shfuqizohet ai vendim nuk mund të veprojnë ndryshe policia, gjithashtu me herët i keni adresuar disa pyetje, nënkyretari do t'iu pergjigjet.
- z. Besart Tofaj:** Qeshtja druve ato dru janë marr afër restaorantit qe është demoluar ura qe është duke u rregulluar rruga dhe ato dru janë dërguar në shkollën fillore per djegie.
- z. Demokrat Ganijaj:** Sa i përket druve është prishe ura ato jon kon dru industriale ekam marr lejen prej banoreve të lagjes Jasiq me mire kuptimin e tyre i kam dërguar ne shkollën fillore per djegie, transportin e tyre e ka bere kompania e cila është duke bere punimet ne rrugën e Jasiqit, drutë nuk janë dërguar te individët, por janë shkuar në shkollë pasi që është paraqitur nevoja.
- z. Zenel Maloku:** Replikë për ketë temë, Drejtor sa i përket furnizimit per dru per shkolla edhe ne oborrin tim jam dakord mej marr dhe me ju dërguar, por banoret nuk minden me leshu leje sespe është e jashtë ligjshme, pse nuk i leshut drut shelnje qe e kërkuan banorët e Jasiqit.
- z. Demokrat Ganijaj:** Sa i përket shenjezimit të rrugëve është nënshkruar kontrata, menaxheri i komunikacionit do ta menaxhon punën.

**z. Shpejtim Gacaferi:** E shpalli të mbyllur mbledhjen e gjashtë të Kuvendit Komunal në Junik, ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:45.

Procesmbajtësi:

z. Arton Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

